



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE

*STATISTIKA PËR VEPRIMTARINË
GJYQËSORE TË GJYKATËS KUSHTETUESE*

PËR VITIN 2022

KËRKESAT DREJTUAR GJYKATËS KUSHTETUESE GJATË VITIT 2022

Gjatë vitit 2022 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka marrë në shqyrtim 36 çështje të mbartura nga viti 2021, si dhe **291**¹ kërkesat e paraqitura dhe të regjistruara gjatë këtij viti, nga të cilat:

- ✚ 52 kërkesa janë në fazën e shqyrtimit paraprak nga Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese;
- ✚ 1 kërkesë është në fazën e shqyrtimit paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve;
- ✚ 32 kërkesa janë në shqyrtim në seancë plenare;
- ✚ Për 28 kërkesa është marrë vendim përfundimtar;
- ✚ Për 175 kërkesa është marrë vendim moskalimi.


Më poshtë po paraqesim të dhëna statistikore për kërkesat e paraqitura gjatë vitit 2022, të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, si dhe sipas objektit të kërkesës:

➤ Kërkesat e grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:

- ✚ 11 kërkesë janë paraqitur nga jo më pak se 1/5-a, e deputetëve;
- ✚ 13 kërkesa janë paraqitur nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (për kontroll incidental);
- ✚ 1 kërkesë është paraqitur nga partitë politike;
- ✚ 22 kërkesa janë paraqitur nga organizatat;
- ✚ 244 kërkesa janë paraqitur nga individët.

¹ 6 kërkesa janë bashkuar dhe do shqyrtohen në 3 çështje.


Kërkesat e grupuara sipas subjekteve



➤ Kërkesat e grupuara sipas objektit:

- ✚ 191 kërkesa janë paraqitur për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në kuadër të procesit të rregull ligjor;
- ✚ 32 kërkesa janë paraqitur për konstatimin e cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm;
- ✚ 12 kërkesa janë paraqitur për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, si dhe konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm;
- ✚ 11 kërkesa janë paraqitur për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, si dhe shfuqizim të akteve normative;

- ✚ 33 kërkesa janë paraqitur për papajtueshmëri të ligjeve (apo dispozitave të veçanta të tyre) me Kushtetutën;
- ✚ 3 kërkesë është paraqitur për konflikt kompetencash;
- ✚ 1 kërkesa është paraqitur për shfuqizim urdhri të Ministrit të Shëndetësisë;
- ✚ 1 kërkesa është paraqitur për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave
- ✚ 3 kërkesa është paraqitur për interpretim/ korrigjim/ rishikim të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese;
- ✚ 1 kërkesë është paraqitur për shfuqizim vendimi Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- ✚ 1 kërkesë është paraqitur për shfuqizim vendimi Këshillit të Lartë të Gjyqësor;
- ✚ 2 kërkesa janë paraqitur për kundërshtim të akteve të pushtetit publik.



VENDIMET E MARRA NGA GJYKATA KUSHTETUESE GJATË TË VITIT 2022

Gjykata Kushtetuese gjatë vitit 2022 ka dhënë në total 238 vendime, nga të cilat 43 vendime janë përfundimtare dhe 195 janë vendime moskalimi;

Më poshtë paraqesim në mënyrë grafike vendimet përfundimtare të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas objektit të kërkesës, sipas vitit të regjistrimit, sipas dispozitivit të vendimit, si dhe sipas mënyrës së votimit.


➤ Vendimet përfundimtare të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:

- 1 vendim i përket kërkesës së paraqitur nga Kuvendi i Shqipërisë;
- 3 vendim i përkasin kërkesave të paraqitura nga një grup deputetësh;
- 29 vendime i përkasin kërkesave të paraqitura nga individët;
- 6 vendime i përkasin kërkesave të paraqitura nga shoqëritë;
- 4 vendim i përkasin kërkesave të paraqitura nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (kontroll incidental).



➤ Vendimet përfundimtare të grupuara sipas objektit të kërkesës


- ✚ 1 vendim është me objekt *për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë*;
- ✚ 9 vendime janë me objekt *papajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*;
- ✚ 1 vendim është me objekt *konflikt kompetencash*;
- ✚ 28 vendime janë me objekt *kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në kuadër të procesit të rregull ligjor*;
- ✚ 2 vendim janë me objekt *konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm*;
- ✚ 2 vendime janë me objekt *shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, si dhe konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm*;



➤ Vendimet përfundimtare sipas vitit të regjistrimit të kërkesës:

- 15 vendime ju përkasin kërkesave të regjistruara në vitin 2021;
- 28 vendime ju përkasin kërkesave të regjistruara në vitin 2022


Vendimet përfundimtare sipas vitit të regjistrimit të kërkesës në %



➤ Vendimet përfundimtare të grupuara sipas dispozitivit të vendimit:


- ✚ Për 14 vendime Gjykata ka vendosur *pranimin e kërkesës*;
- ✚ Për 9 vendime Gjykata ka vendosur *pranimin pjesërisht të kërkesës*;
- ✚ Për 20 vendime Gjykata ka vendosur *rrëzimin e kërkesës*;

VENDIME PËRFUNDIMTARE TË GRUPUARA SIPAS DISPOZITIVIT



➤ Vendimet përfundimtare të grupuara sipas mënyrës së votimit:

- ✚ 24 vendime *njësëri*;
- ✚ 15 vendime me *shumicë votash*;
- ✚ 4 vendime *pa kuorum*;




Gjatë vitit 2022 nga Mbledhja e Gjyqtarëve dhe Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese janë dhënë 195 vendime moskalimi;

Më poshtë paraqesim në mënyrë grafike vendimet e moskalimit të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas objektit të kërkesës, sipas vitit të regjistrimit, sipas Kolegjeve/Mbledhjes së Gjyqtarëve;

➤ Vendimet e moskalimit të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:

- ✚ 10 vendime ju përkasin kërkesave të paraqitura nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (për kontroll incidental);
- ✚ 2 vendim i përket kërkesës së paraqitur nga partitë politike;
- ✚ 13 vendime ju përkasin kërkesave të paraqitura nga organizatat;
- ✚ 170 vendime ju përkasin kërkesave të paraqitura nga individët.


Vendime moskalimi të grupuar sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese



➤ Vendime moskalimi të grupuara sipas objektit të kërkesës:

- ✚ 18 vendime janë me objekt *papajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*;
- ✚ 128 vendime janë me objekt *kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në kuadër të procesit të rregull ligjor*;
- ✚ 3 vendime janë me objekt *shfuqizim vendimesh të Këshillit të Ministrave*
- ✚ 2 vendime janë me objekt *papajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, si dhe kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm*;
- ✚ 26 vendime janë me objekt *konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm*;
- ✚ 9 vendime janë me objekt *kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, si dhe konstatimin e cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm*;
- ✚ 1 vendim është me objekt *kundërshtim vendimi të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (Juridiksion disiplinor)*;
- ✚ 5 vendime janë me objekt *saktësim/interpretim vendime të Gjykatës Kushtetuese*;
- ✚ 1 vendim është me objekt *kundërshtim vendimi të Këshillit të Lartë të Prokurorisë*;
- ✚ 1 vendim është me objekt *shfuqizim Urdhri Ministri*;
- ✚ 1 vendim është me objekt *rivendosje në afat e së drejtës së paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese*.


Vendime moskalimi të grupuara sipas objektit



➤ Vendimet e moskalimit sipas vitit të regjistrimit të kërkesës:

- ✚ 20 vendime ju përkasin kërkesave të regjistruara në vitin 2021;
- ✚ 75 vendime ju përkasin kërkesave të regjistruara në vitin 2022.


Vendime moskalimi sipas vitit të regjistrimit të kërkesës



➤ Vendime moskalimi të marra nga Kolegjet dhe Mbledhja e Gjyqtarëve:

- ✚ 170 vendime janë marrë nga Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese;
- ✚ 25 janë marrë nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Vendime moskalimi të marra nga Kolegjet dhe Mbledhja e Gjyqtarëve



Aktualisht (datë 04.01.2023) numri total i kërkesave që presin të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese është **85**, nga të cilat:

- ✚ 32 kërkesa janë në shqyrtim në seancë plenare;
- ✚ 1 kërkesë është në shqyrtim paraprak nga Mbledhjen e Gjyqtarëve;
- ✚ 52 kërkesa janë në fazën e shqyrtimit paraprak nga Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese;

Janar 2023

Përgatiti:

Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit